

	Ndalohej duhani, flakët dhe shkëndijat		Në rast të kontaktit të acidit me sytë ose lëkurën lajini me ujë të bollshëm dhe të pastër. Më pas kërkoni ndihmë mjekësore. Acidi në rroba duhet larë me ujë
	Elektroliti është gërryes		Lexoni udhëzimet
	Rrezik elektrik		Ricikloni bateritë e përdorura të shkarkuara. Përbajnë plumb
	Mbroni sytë		Paralajmërim: Rrezik zjarri, shpërthimi ose djegiesh. Mos e çmontoni, mos e nxehni mbi 60°C ose mos e digjini. Shmangni çdo lidhje të shkurtër. Bateria ka pjesë metalike në tension, mos vendosni vegla ose objekte sipër baterisë
	Rrezik		



Fletë udhëzimi

Paralajmërim, Propozimi i 65-të i shtetit të Kalifornisë - Polet, terminalet dhe pajisjet përkatëse të baterive përbajnë plumb dhe materiale përbërëse të plumbit, kimikate të njohura në shtetin e Kalifornisë si shkaktare të kancerit dhe të shëndetit riprodhues. Lani duart pas përdorimit.

Bateritë e teknologjisë PowerSafe® SBS® EON® janë të karikuara me rrymë dhe mund të shkaktojnë rryma jashtëzakonisht të larta në rast të qarkut të shkurtër. Kujdesuni që të shmangni krijimin e qarkut të shkurtër mes terminaleve të polaritetit të kundërt.

1. Pranimi

Pas pranimit të një dërgese, kontrolloni që artikujt e dorëzuar janë të padëmtuar dhe në përputhje me faturën e ngarkesës nga ana e transportuesit. Raportoni dëmet ose mungesat tek transportuesi. EnerSys® nuk mban përgjegjësi për dëmtimet gjatë transportimit ose mungesat që marrësi nuk i raporton transportuesit.

2. Ruajtja


2.1 Kushtet dhe Koha e Magazinimit

Nëse një bateri nuk mund të instalohet menjëherë duhet të magazinohet në një vend të pastër, të freskët dhe të thatë.

Gjatë magazinimit bateritë e humbasin kapacitetin përmes vetë-shkarkimit.

Temperaturat e larta rrisin shkallën e vetë-shkarkimit dhe reduktojnë jetëgjatësinë e magazinimit.

Tabela më poshtë tregon lidhjen midis tensionit të qarkut të hapur (OCV) dhe kohës së magazinimit në temperatura të ndryshme.



2.2 Rikarikimi

Bateritë mono-blok dhe qelizat duhet të rikarikohen kur OCV-ja i afrohet ekuivalentit të 2.10 Volt për qelizë ose kur është arritur koha maksimale e magazinimit.

Rikarkimi duhet të kryhet me karikim konstant të tensionit ndërmjet 2.29 dhe 2.40Vpc me kufizimin e rrymës 0.1C₁₀ A për 24 orë. Intervalet e auditit OCV të rekomanduara jepen në tabelën më poshtë.

Temperatura (°C / °F)	Koha e magazinimit (muaj)	Intervale të auditimit OCV (muaj)
+10 / +50	48	6
+15 / +59	34	6
+20 / +68	24	4
+25 / +77	17	4
+30 / +86	12	3
+35 / +95	8.5	2
+40 / +104	6	2

2.3 Karikimi fillestar

Para fillimit të operimit apo të përdorimit, bateria duhet të ketë një karikim fillestar.


Në përdorimet e plotësuese (Float application) karikimi fillestar konsiston në 7 ditë të vazhdueshme të karikimit plotësues në tensionin e rekomanduar plotësues (2.29Vpc at 20°C) pa ngarkesë të lidhur me baterinë. Në përdorimet hibride karikimi fillestar konsiston në 24 orë karikim në një tension të barabartë me 2.40 Volt/qelizë pa ngarkesë të lidhur.

3. Instalimi

Pavarësisht përdorimit, bateritë e teknologjisë PowerSafe SBS EON mund të montohen në çfarëdo drejtimi, duke përjashtuar pozicionin përmbys. Megjithatë, në përdorimet ciklike/hibride EnerSys

Rekomandon që qelizat SBS EON Technology 2V të standardit DIN të instalohen në drejtimin horizontal. Në këto konfigurime duhet të zbatohen udhëzimet e mëposhtme.

- Mos përdorni polet e terminaleve për të ngritur ose trajtuar qelizat.
- Mos i instaloni qelizat në mënyrë të tillë që lidhja ndërmjet kutisë dhe kapakut të baterisë të jetë në kontakt me raftin.
- Sigurohuni që shigjeta në kapakun e çdo njësie ka orientim vertikal.



Hapësira/dhoma e baterisë duhet të ketë ventilimin e duhur për të kufizuar akumulimin e hidrogjenit në vlerën maksimale prej 1% të vëllimit të ajrit të lirë.

Çdo bateri është e paisur me shtrënguesit dhe lidhëset e terminaleve.

Në çdo bateri terminali pozitiv identifikohet me simbolin "+". Instaloni bateritë në përputhje me udhëzimet dhe/ose vizatimet e jashtme, duke u siguruar që vendndodhja dhe polariteti i terminaleve është pozicionuar në mënyrë korrekte.

Lidhni bateritë me lidhëset dhe shtrënguesit e ofruar. Shtrëngoni mirë vidat/dadot në nivelin e shtrëngimit të treguar në etiketën e produktit.

Vendosni menjëherë kapakët izolues në pozicion pasi ti keni shtrënguar mirë.

4. Funksionimi

Bateritë e Teknologjisë PowerSafe® SBS® EON Technology® kanë karakteristikat e jetëgjatësisë së madhe plotësuese dhe të magazinimit si modulet mono-blok dhe qelizat tradicionale të PowerSafe SBS me përfitimet shtesë të aftësisë së përmirësimit të ciklit si në tensionin plotësues edhe në atë të karikimit të shpejtë.

4.1 Operimi në pritje/ i qetë (Float Operation)

Rekomandohen karikues të tensionit konstant. Tensioni karikues duhet të vendoset në vlerën e barabartë me 2.29Vpc në 20°C/68°F ose 2.27Vpc në 25°C/77°F.

Operimi në temperatura më të larta se 20°C do të reduktojë jetëgjatësinë e pritshme. Zakonisht jetëgjatësia reduktohet me 50% për çdo 10°C që rritet temperatura. Për të shmangur ndikimin e temperaturave të larta duhet të përdoret kompenzim tensioni plotësues.

Kompenzimi i rekomanduar i tensionit plotësues ndaj temperaturës është:

	Temperatura (°C / °F)						
	10/50	15/59	20/68	25/77	30/86	35/95	40/104
E rekomanduar	2.33	2.31	2.29	2.27	2.25	2.23	2.21
Minimum	2.31	2.29	2.27	2.25	2.23	2.21	2.21

Për shkak të rezistencës të brendshme shumë të ulët bateritë PowerSafe SBS EON pranojnë rrymë të pakufizuar gjatë rikarikimit por për arsye të kostos dhe për arsye praktike në përdorimet plotësuese ku koha e rikarikimit për të përsëritur detyrën nuk është kritike, rryma e ridrejtuesit mund të kufizohet në rrymën e ngarkesës plus 0.1C₁₀ Amp.

4.2 Cyclic Operation

Përveç karakteristikave të jetëgjatësisë së madhe të trashëguar nga dizajnet tradicionale PowerSafe SBS TPPL, Teknologjia EON Technology është projektuar për të ofruar performancë të lartë në përdorimet kur bateria i nënshtrohet detyrave ciklike të përsëritura ose ku besueshmëria e energjisë testohet në temperatura të larta dhe kushte të vështira të kombinuara me vendndodhje të largëta.

Në përdorimet ciklike tensioni karikues duhet të vendoset në vlerën e barabartë me 2.40Vpc në 20°C/68°F, ku rryma minimale e ridrejtuesit caktohet në limitin prej 0.1C₁₀ A (Teknologjia EON Technology është projektuar të përballojë rryma të forta të pakufizuara pa dëmtuar në strukturën e brendshme elektro-kimike).

Performanca ciklike optimale arrihet duke rikthyer baterinë në gjendje të plotë të karikimit midis cikleve të shkarkimit. Është e mundur të përdoren modulet mono-blok dhe qelizat e SBS EON Technology në gjendje pjesërisht të karikuar, megjithatë, në këto situata është shumë e rëndësishme të sigurohet që bateria në mënyrë periodike të kthehet përsëri në gjendje plotësisht të karikuar për të ruajtur gjendjen funksionale të baterisë.

Rekomandohet të kontaktoni përfaqësuesin tuaj të EnerSys® për të marrë informacion shtesë dhe udhëzime për këto aplikacione.

Në sistemet ku kontrolli i faktorit të karikimit nuk është i mundur, mund të jetë e mundur të vlerësohet koha për gjendjen e plotë të karikimit duke përdorur përlogaritjen:

Koha e rikarikimit (orë) = 2* ((0.8 x shkarkim Ah) / energji e kufizuar) +1 Kompensimi i rekomanduar për tensionin e karikimit në përdorimet ciklike është:

	Temperatura (°C / °F)						
	10/50	15/59	20/68	25/77	30/86	35/95	40/104
Vpc	2.44	2.42	2.40	2.38	2.36	2.34	2.32

5. Mirëmbajtja

Në praktikë, përdoruesi zakonisht specifikon orarin e mirëmbajtjes bazuar në rëndësinë e sajtit, vendndodhjen dhe fuqinë punëtore. Sidoqoftë, informacionet e mëposhtme mund të përdoren si orar i sugjeruara i mirëmbajtjes.

• Mujore (regjistroni të gjitha të dhënat)

Matni tensionin grupit të baterive. Nëse është e nevojshme, rregulloni tensionin plotësues në vlerën e duhur.

• Çdo gjashtë muaj (regjistroni të gjitha të dhënat)

Matni tensionin e stringut të baterive. Nëse është e nevojshme, rregulloni tensionin plotësues në vlerën e duhur. Matni tensionin individual të baterive/qelizave. Bateritë/qelizat duhet të jenë brenda 5% të mesatares.

Kontrolloni për ndotje nga pluhuri, lidhjet e paqëndrueshme ose të korroduara. Nëse është e nevojshme izoloni stringun/bateritë/qelizat dhe pastroni me një leckë të butë të lagur. Vërejtje - MOS përdorni asnjë lloj vaji, tretësi, pastruesi, tretësi me bazë naftë ose solucion me amoniak për të pastruar kontejnerët ose kapakët e baterisë.

Këto materiale do të shkaktojnë dëme të pariparueshme në kontejnerin dhe kapakun e baterisë dhe do të zhvlerësojnë garancinë.

Kontakti EnerSys® nëse keni pyetje në lidhje me mirëmbajtjen.

6. Hedhja pas përdorimit

Bateritë PowerSafe SBS EON Technology janë të riciklueshme.

Bateritë e përdorura duhet të paktohen dhe të transportohen në përputhje me rregullat e transportit dhe rregulloreve në fuqi.

Bateritë e përdorura duhet të hidhen në përputhje me ligjet lokale dhe kombëtare nga një riciklues i baterive me acid plumbi i licencuar ose i certifikuar.



www.enersys.com

EnerSys
World Headquarters
 2366 Bernville Road
 Reading, PA 19605
 USA
 Tel: +1 610 208 1991
 +1 800 538 3627
 Fax: +1 610 372 8613

EnerSys EMEA
 EH Europe GmbH
 Baarerstrasse 18
 6300 Zug
 Switzerland
 Tel: +41 44 215 7410

EnerSys ASIA
 152 Beach Road
 Gateway East Building
 #11-08
 Singapore 189721
 Tel: +65 6416 4800

Contact

© 2019 EnerSys. All rights reserved.
 Trademarks and logos are the property of EnerSys
 and its affiliates unless otherwise noted.